



*Komuna e Podujevës * Opština Podujevo * Municipality of Podujevo*

KUVENDI

Në bazë të nenit 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë nr.2000/45, Udhëzimit administrativ nr.2001/2 dhe nr.2001/3 për implementimin e Rregullores nr.2000/45, nenit 18.1 pika I dhe nenit 38 al.3 pika të Statutit të komunës së Podujevës, Kuvendi i komunës i Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2005, miratoi këtë :

RREGULLORE

PËR CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1. Me këtë Rregullore caktohet orari i punës për subjektet afariste në komunën e Podujevës
- 1.2 Subjektet afariste të regjistruara sipas dispozitave ligjore në fuqi janë të detyruara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

II PËRKUFIZIME

Neni 2

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimet vijuese:

- “Periudhë verore” nënkupton periudhën e vitit prej 01.04. deri më 31.10.
- “Periudhë dimërore” nënkupton periudhën e vitit prej 01.11. deri më 31.03.
- “Vikend” nënkupton të premten në mbrëmje, të shtunën dhe të dielën.

III ORARI I PUNËS

Neni 3

Veprimtaritë zejtare

- 3.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 20.00
- 3.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 19.00
- 3.3 Të dielave dhe festave nuk punojnë.

3.4 Përjashtim nga pika 3 e këtij neni bëjnë sallonet e ondulimit,të cilat

punojnë edhe të dielave.

3.5 Furrat e bukës punojnë çdo ditë prej orës.....04.00 deri në orën 22.00

Neni 4

Veprimtaritë tregtare me shumicë(ushqimore dhe jo ushqimore)

4.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....06.00 deri në orën 21.00

4.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 20.00

4.3 Të dielave dhe festave nuk punojnë.

4.4 Përjashtim nga pika 3 e këtij neni bëjnë depot e materialit ndërtimor të cilat gjatë periudhës verore mund të punojnë të dielave prej orës 07.00 deri në orën 12.00.

Neni 5

Veprimtaritë tregtare ushqimore me pakicë

5.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 21.00

5.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 20.00

5.3 Të dielave dhe festave nuk punojnë

5.4 Me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve gjatë ditëve që nuk punohet do të aplikohet sistemi i kujdestarisë të cilin do ta përcakton Drejtoria për Ekonomi, Planifikim dhe Zhvillim.

Neni 6

Veprimtaritë tjera tregtare me pakicë

6.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 21.00

6.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 20.00

6.3 Të dielave dhe festave nuk punojnë.

Neni 7

Hotelet,motelet

7.1 Gjithë vitin punojnë prej orës.....00.00 deri në orën 24.00

7.2 Pas orës 00.00 nuk lejohet shërbimi i mysafirëve jashtë objektit ku ushtrohet veprimtaria.

Neni 8

Restorantet

- 8.1 Gjithë vitin punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 23.00
8.2 Vikendeve punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 24.00

Neni 9

Kafebaret,kafiteritë,internet kafet,lojrat e fatit,ëmbëltoret,burektoret,gebaptoret,qajtoreset,kiosqet në të cilat pëgatitet ushqimi i shpejtë.

- 9.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 23.00
9.2 Vikendit kafe baret punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 24.00
9.3 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....07.00 deri në orën 22.00
9.4 Vikendit kafe baret punojnë prej orës.....07.00 deri në në orën 23.00

Neni 10

Disko klubet dhe klubet e natës

- 10.1 Punojnë gjatë vikendeve prej orës.....22.00 deri në orën 05.00.

Neni 11

Veprimtaritë shërbyese

- 11.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 21.00
11.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 19.00
11.3 Të dielave dhe festave nuk punojnë.
11.4 Gjatë periudhës verore përjashtim nga pika 3 e këtij neni bëjnë agjencionet e udhëtimit.

Neni 12

Objektet për shitjen e karburanteve dhe lubrifikanteve

- 12.1 Punojnë prej orës.....06.00 deri në orën 24.00
12.2 Përjashtim nga kjo bëjnë subjektet që ushtrojnë veprimtarinë sipas këtij neni përgjatë magjistrates Merdar-Podujevë-Prishtinë të cilat mund të punojnë non-stop.

Neni 13

Barnatoret

- 13.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 21.00
13.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 20.00
13.3 Të dielave dhe festave nuk punojnë.
13.4 Me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve do të kujdestarohen dy barnatore
Orarin në formë të shkruar e cakton Drejtoria për Ekonomi, Planifikim dhe Zhvillim në bazë të alfabetit të mbishkrimeve të barnatoreve.
Orari i kujdestarisë caktohet për një muaj.
13.5 Orari i kujdestarisë duhet të vendoset në të gjitha barnatoret dhe në Shërbimin e emergjencës në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare në qytet.

Neni 14

Veprimtaritë private mjekësore, stomatologjike dhe të tjera

- 14.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 21.00
14.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 20.00
14.3 Mund të bëhet përjashtim në pikat 1 dhe 2 të këtij neni për rastet emergjente të cilat për shkaqe të ndryshme nuk mund të trajtohen në institucionet publike shëndetësore.

Neni 15

Tregu i gjelbër

- 15.1 Në periudhën verore punon prej orës.....07.00 deri në orën 20.00
15.2 Në periudhën dimërore punon prej orës.....07.00 deri në orën 19.00
15.3 Të dielave dhe festave nuk punon.

Neni 16

Tregu i kafshëve, i automjeteve

- 16.1 Punojnë vetëm të shtuneve prej orës.....06.00 deri në orën 16.00

Neni 17

Veprimtaritë rekreativo-sportive

- 17.1 Në periudhën verore punojnë prej orës.....08.00 deri në orën 24.00
17.2 Në periudhën dimërore punojnë prej orës.....09.00 deri në orën 22.00
17.3 Për objektet e mbuluara gjatë gjithë vitit vlen orari veror.

Neni 18

Veprimtaritë prodhuese

- 18.1 Në funksion të stimulimit të prodhimit, subjekteve afariste iu lejohej ta caktojnë orarin e punës në bazë të nevojave dhe vëllimit të punës.
18.2 Subjektet afariste janë të detyruara ta vërtetojnë orarin e punës në Drejtorinë për Ekonomi, Planifikim dhe Zhvillim.

Neni 19

Subjektet afariste të cilat nuk janë të përfshira në dispozitat e kësaj Rregulloreje e propozojnë orarin e punës të cilin në formë të shkruar e përcakton dhe e vërteton Drejtoria për Ekonomi, Planifikim dhe Zhvillim.

Neni 20

- 20.1 Subjektet afariste janë të detyruara që orarin e punës të përcaktuar me këtë Rregullore ta vendosin në vend të dukshëm në objektin ku ushtrohet veprimtaria.
20.2 Subjektet afariste në mënyrë të pavarur mund të caktojnë një ditë pushimi gjatë javës

Neni 21

Subjektet afariste gjatë ushtrimit të veprimtarisë janë të detyruara t'i përmbahen dispozitave të Ligjit për rendin dhe qetësinë publike.

IV ZGJATJA E ORARIT TË PUNËS

Neni 22

- 22.1 Subjektet afariste sipas kësaj Rregulloreje mund të punojnë më gjatë se orari i punës i caktuar me këtë Rregullore.
22.2 Për punë më të gjatë se orari i paraparë duhet marrë pëlqim nga Drejtoria për Ekonomi, Planifikim dhe Zhvillim dhe duhet paguar taksë shtesë në shumën 20,00 € për një orë.

22.3 Kërkesës për punë shtesë subjekti afarist duhet t'ia bashkangjesë fletë-pagesën e taksës dhe fotokopjen e lejes për punë të lëshuar nga organi kompetent.

Neni 23

23.1 Subjektet afariste nga nenet 8,9 dhe 17 mund të zgjasin orarin e punës me rastin e festave deri në orën 01.00.

23.2 Për festën e Vitit të Ri deri në orën.....04.00.

23.3 Barnatoret bujqësore gjatë fushatës së korrje-shirjeve mund të punojnë sipas nevojës.

V DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 24

24.1 Subjektet afariste të cilat nuk i përmbahen nenit 1.2 do të ndëshkohen për kundërvajtje si vijon:

- Personat juridik.....200.00 €
- Personi përgjegjës në personin juridik.....150.00 €
- Personat fizikë.....100.00 €

24.2 Subjektet afariste të cilat konstatohet se nuk ju kanë përmbajtur kushteve nga neni 22,do të ndëshkohen për kundërvajtje si vijon:

- Personat juridik.....200.00 €
- Personi përgjegjës në personin juridik.....150.00 €
- Personat fizikë.....100.00 €

VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Subjektet afariste janë të detyruara të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje,në afatin prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi.

Neni 26

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi,Planifikim dhe Zhvillim,ndërsa mbikëqyrjen do ta bëjnë Drejtoria për Inspeksion dhe policia.

Neni 27

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për caktimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë,hotelierisë,zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e komunës së Podujevës nr.02-1/222-361 e datës 05.10.2001 dhe ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për caktimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë,hotelierisë,zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e komunës së Podujevës nr.02-1/260-130,e datës 20.12.2001.

Neni 28

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit.

Nr.01-1 / 21-02
Podujevë,
18 mars 2005

Kryetari
Agim Kikaj

